



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:137742

Datë: 25.03.2022

Numri i dokumentit: 02840645

**P.nr. 915/20**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Afërdita Kicaj, në lëndën penale kundër të akuzuarës J.A. nga Prizreni rr. .... për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr. 06/L-074 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, nën numrin PP/II.nr.1856-3/2020 të datës 19.10.2020, në shqyrtimin gjyqësor, në prezencën e prokurorit të shtetit Petrit Kryeziu, të dëmtuarit dhe të akuzuarës nga Prizreni, me datë 22.03.2022 në prezencën e palëve publikisht mori dhe shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

Kundër të akuzuarës:

**J.A.** nga i ati R. e ëma Z. e vajzërisë K. e lindur me datë .... nga Prizreni, në rr. .... kati i II. shqiptare, me numër personal .... shtetase e Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par.1 nën par.1.1 dhe të KPPRK.

## **REFUZHET AKUZA**

Se prej datës së pavërtetuar e deri me datën 20.08.2020, në Prizren, në shtëpinë e saj familjare e cila gjendet në rr. “Besim Shala 439” pa nr. gjatë një kontrolli të bërë nga ekipi i kompanisë “KEDS” rezulton se e pandehura J.A., me qëllim që të përfitoj në mënyrë të kundërligjshme nga shërbimi komunal, i cili mundësohet vetëm me pagesë, shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, e njëjta është lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë në rrjetin e energjisë elektrike, jashtë njehsorit elektrik nr. 32595195, e cila

ka qenë e shkyçur nga distanca, me nr. unik të konsumatorit DPZ 9050012, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar e as faturuara, me ç 'rast kompanisë "KEDS" Distrikti në Prizren i ka shkaktuar dëm material.

**Këso dore kishte për të kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK nr. 06/L-074.**

Për shkak se Prokurori Shtetit në Prizren – në shqyrtimin gjyqësor në mbështetje të nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK, është tërhequr nga aktakuza.

E dëmtuara "KEDS" për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr. 1856-3/2020 të datës 19.10.2020, kundër të akuzuarës J. A. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK.

Gjykata pas pranimit të shkresave të lëndës dhe pas kontrollimit të aktakuzës, ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 10.03.2022, në të cilën seancë, pas leximit dhe elaborimit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, e akuzuara ka deklaruar se ka kuptuar në tërësi aktakuzën, dhe e njëjta nuk e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë. E akuzuara nga ana e gjykatës është udhëzuar që para shqyrtimit të dytë të parashtrij kundërshtimin për provat e cekura në aktakuzë dhe të arsyetojë kundërshtimin e tyre dhe kërkesës për hedhjen e aktakuzës si dhe të paraqes prova të reja me të cilat do të vërtetohet faktet dhe rrethanat të cilat shkojnë në favor të mbrojtjes.

E akuzuara thekson se heq dorë nga kërkesa për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave duke theksuar se është e domosdoshme që të mbahet edhe shqyrtimi gjyqësor, në të cilin shqyrtim do të vërtetohet çështja për të cilën unë ngarkohem gjegjësisht pafajësia ime dhe që kjo çështje të kalohet - shkohet me shqyrtim gjyqësor, ku do të dëgjohet edhe dëshmitari ish bashkëshorti im E.A. nga Prizreni.

Prokurori i shtetit nuk e kundërshton propozimin e të akuzuarës që të shkohet drejtpërdrejt në shqyrtim gjyqësor.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësorë me datën 22.03.2022, Prokurori Shtetit Petrit Kryeziu, ka deklaruar se Heqë dorë nga dëgjimi i dëshmitarëve N.K. dhe Xh.A. dhe po ashtu heq dorë nga leximi i provave materiale të propozuara sikurse në aktakuzë për faktin se e pandehura J.A. në të njëjtën ditë ka pasur edhe dy seanca tjera gjyqësore në po të njëjtën gjykatë mirëpo te gjykatësi tjetër e akuzuar për veprën penale të vjedhjes së shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së ku në lëndën me nr. PP/II.nr.2225-2/21 të dt.15.11.2021 është dëgjuar dëshmitari E.A. i cili ka deklaruar se shtëpinë familjare e cila gjendet në rr. "Besim Shala" nr.439 e cila shfrytëzon njehsorin elektrik me nr. 32595195 me nr. unik të

konsumatorit DPZ 9050012 nga viti 2018 e pandehura J.A. nuk e shfrytëzon ngase nga ajo kohë e njëjta është shkurorëzuar me dëshmitarin E.A. ky i fundit i marr në pyetje në cilësinë e dëshmitarit ka deklaruar se është pikërisht ai i cili që nga viti 2018 është duke e shfrytëzuar këtë njehsor elektrik. Andaj me qëllim të ekonomizimit të procedurës nga njëra anë dhe nga ana tjetër duke pas parasysh të drejtat e të pandehurës të cilat burojnë nga ligjet vendore si dhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut të cilës i garantohet gjykimi i drejtë dhe në kohë të arsyeshme dhe mbi të gjitha i garantohet edhe prezumimi i pafajësisë duke marr parasysh të lartë cekurat në këtë çështje penale që nga fillimi i ngritjes së aktakuzës nuk ka qenë kontestuese se është kryer vepra penale, një gjë e tillë vazhdon të jetë e pakontestueshme mirëpo në rastin konkret është vërtetuar se subjekt i kryerjes së kësaj vepre penale nuk është e pandehura J.A. për të cilën tani më ekziston një numër i madh i aktakuzave të ngritura për periudhën për të cilën e njëjta nuk e ka shfrytëzuar njehsorin elektrik për të cilin ngarkohet. I gjendur para një situatë të tillë konform dispozitave të nenit 52 të KPPRK-së TËRHIQEM nga ndjekja penale ndaj të akuzuarës J.A. nga aktakuza nr. PP/II. nr. 1856-3/20 të datës 19.10.2020 ndërsa propozojmë përfaqësuesin e palës së dëmtuar që të paraqet kallëzim penal të ri ndaj shfrytëzuesit të njehsorit elektrik me nr. 32595195 i cili e ka shfrytëzuar deri më datën 20.08.2020.

Gjykata, pas shqyrtimit të kërkesës për hedhjen e aktakuzës, mendimin e Prokurorit të shtetit, dhe të akuzuarit, si dhe pas shikimit të shkresave të çështjes ka konstatuar se kërkesa është e bazuar në ligj.

Gjykata, vlerëson se pretendimet nga kërkesa për hedhjen e aktakuzës, se nga provat të cilat i përmban aktakuza nuk e vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale, kanë justifikim juridike dhe mbështetje ligjore, për hedhjen e aktakuzës, sepse janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 253 par.1 nën par. 1.4 të KPP-së, sepse nuk ka rrethana që përjashtojnë përgjegjësin penale, nuk ka parashkrim të ndjekjes penale, amnisti apo falje, ndërsa nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë se e akuzuara ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë me aktakuzë.

Meqenëse prokurori shtetit në shqyrtim gjyqësor është tërhequr nga aktakuza kundër të akuzuarës, gjykata konform nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK ka vendosur si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 454 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimin mbi kërkesën pasurore juridike gjykata e mori konform nenit 463 par.3 të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2020:137742, 22.03.2022**

## G j y q t a r i

---

Gani Kastrati

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.